



MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM – (MpB)


në mes të

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës me regjistrim

Nr: 5200122-6 – në tekstin e mëtejme i referuar si “IADK”

dhe

Kuvendit Komunal të Vushtrrisë në tekstin e mëtejme referuar si “Komuna e Vushtrrisë”



I. Fushëveprimi i MpB

IADK-ja dhe Komuna e Vushtrrisë pajtohen të rregullojnë një bashkëpunim të afërt me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë së projekteve bujqësore të realizuara nga IADK-ja në Komunën e Vushtrrisë.

Momentalishtë, IADK është duke zbatuar projektin “Përfshirja ekonomike e të riatdhesuarve përmes bujqësisë në zonat rurale dhe ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve profesionale” në komunat: Rahovec, Malishevë, Skënderaj, Drenas dhe Klinë përkrahur nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, i mandatuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë. Kjo MpB ka qëllimin të themeloj dhe përshkruaj bashkëpunimin në mes të IADK-së dhe Komunës së Vushtrrisë gjatë periudhës Janar – Qershor 2020 për pikat, të drejtat dhe detyrat për secilën palë të kyçur, ku si qëllim i fundit është ndihma dhe përkrahja e fermerëve të rikthyer të cilët do të jenë në gjendje të rrisin të ardhurat dhe punësimin.

Sipas projektit gjatë kësaj periudhe kohore do të përkrahen edhe 24 të rikthyer në të gjitha komunat e përfshira në projekt.

Palët e lartëpërmendura pajtohen që MpB-ja të përmbajë këto obligime dhe përgjegjësi:

II. Obligimet e Komunës së Vushtrrisë

- Komuna e Vushtrrisë në bashkëpunim me IADK-në do t’i koordinojnë aktivitetet e projektit në sektorin e bujqësisë sipas planifikimeve të përshkruar në projektin e financuar nga GIZ;
- Komuna e Vushtrrisë do të ofroj hapësirat për sesione informuese dhe trajnime me fermer rikthyer;
- Komuna e Vushtrrisë do të sigurojë informacione rreth listave të përfituesve nga grantet e komunës, personave të rikthyer të cilët janë mbështetur si dhe atyre që janë në listë të pritjes për përkrahje, përfitues nga grantet e MBPZHR dhe nga donatorë tjerë;
- Komuna e Vushtrrisë do të lejojë hapësirë për vendosjen e materialeve të ndryshme siç janë listat e përfituesve, materialet informuese si dhe forma tjera të komunikimit me palët e interesit;
- Komuna e Vushtrrisë do të përkrahë IADK-në, në zgjedhjen e përfituesve duke lejuar qasje të pa limituar në çdo familje të të rikthyerëve në Komunën e Vushtrrisë duke përfshirë intervistimet dhe fotografimin e tyre në teren;
- Komuna e Vushtrrisë do të financoj projektin me **20% të shumës** për përfituesit e projektit që përzgjidhet sipas plotësimit të kriterëve. Numri i përfituesve që do të përkrahet do të jetë sipas plotësimit të kriterëve dhe buxhetit të caktuar; ky numër mund të jetë prej **10 deri 20 përfituesë**.



Kontributi i Komunës në bashkëfinancin mund të bëhet pas pranit të raportit nga IADK-ja, por jo më vonë se muaji Prill 2020, në llogarinë bankare të IADK-së: **2027-000021-7128-84**;

- Komuna e Vushtrrisë do të sigurojë që përfituesit e zgjedhur nga IADK nuk kanë marrë grante për të rikthyerit nga programet e ndryshme.

III. Obligimet e IADK-së

- IADK në kuadër të projektit "*Përfshirja ekonomike e të riatdhesuarve përmes bujqësisë në zonat rurale dhe ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve profesionale*" do të përkrahë përfituesit me grante bujqësore, varësisht nga plotësimi i kriterëve;
- Secili përfitues do të përfitojë:
 - Grant në vlerë rreth (mesatarisht) prej **2,400 EURO** në formë të të mirave: serra, pajisje mekanizëm dhe imputeve të tjera sipas aplikacioneve dhe kërkesave të tyre të përkrahur nga projekti, ku rreth **400 Euro do të bashkëfinancohet nga përfituesi dhe 20% nga Komuna**;
 - 1 (një) sesionë informativ për projektin, kushtet dhe mundësitë e projektit;
 - 2 (dy) ditë trajnime në Qendrën e Edukimit të Fermerëve në qendrën e IADK-së;
 - 5 (pesë) vizita të drejtpërdrejta këshillimore;
 - Vizitë studimore 1 (një) ditore në Kosovë dhe një vizitë 2 (dy) ditore në region;
 - Informata për fermerët në lidhje me shitjet, çmimet e produkteve, promovimin më të mirë, promovimi i praktikave bujqësore të qëndrueshme mjedisore;
 - Monitorim dhe këshillim të vazhdueshëm gjatë kohës së zbatimit të projektit.
- IADK së bashku me Komunën e Vushtrrisë do të caktojë vendin e mbijetës së sesioneve të trajnimeve dhe shtrirjen gjeografike të projektit;
- IADK do të bashkëpunojë ngushtë gjatë gjithë procesit të projektit, që nga caktimi i kriterëve për përzgjedhje, sesione informuese, zgjedhje të përfituesve, furnizim dhe monitorime të rregullta;
- IADK do të pajisë përfituesit me të mira për grante dhe materiale edukuese në secilën temë të trajnimit.

IV Përgjegjësitë tjera

- IADK do të raportojë tek Komuna e Vushtrrisë për rezultatet e arritura nga aktivitetet e realizuara në kuadër të kësaj MpB.

V Personat Kontaktues

- IADK dhe Komuna e Vushtrrisë do të emërojnë nga një përfaqësues që të rregullojnë kontaktet më të lehta dhe të drejtpërdrejta në mes dy partnerëve. Personat në fjalë do të përfshihen drejt për së drejti në zbatimin e qetë dhe kohor të kësaj MpB. IADK do të përfaqësohet nga Basri Pulaj projekt menaxher ndërsa Komuna e Vushtrrisë do të përfaqësohet nga Rabiye Zahiti;
- Nënshkruesit e kësaj MpB kanë të drejtë të nominojnë persona tjerë nëse personat e parë të propozuar për shkaqe të ndryshme nuk bashkëpunojnë mirë.



VI Hyrja në fuqi dhe ndërprerja


Kjo MpB është e vlefshme duke filluar nga muaji Dhjetor 2019 dhe zgjatë deri në Qershor 2020. MpB hyn në fuqi duke filluar nga data e nënshkrimit nga të dy palët. Për modifikimin e kësaj MpB palët duhet të vendosin para skadimit të afatit.

Në rast të mosmarrëveshjes/pakënaqësisë nga ndonjëra palë, MpB mund të ndërpritet para afatit të paraparë duke dhënë një njoftim me shkrim 1 muaj më parë dhe duke paraqitur arsyet e ndërprerjes.

VII Mospajtimet

Të dy palët në çdo kohë do të respektojnë dhe zbatojnë kodin e sjelljes të partnerit të tyre, me kujdes të veçantë në pozicionet e paraqitura më lartë.

Iniciativa për Zhyllimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK)




Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv

Vushtrri, 24/12/ 2019



Komuna Vushtrri



Xhafer Tahiri
Kryetar

Vushtrri, 24/12. 2019